

Svit

shpëton jetët



PROGRAMI KOMBËTAR I DEPISTIMIT
DHE I ZBULIMIT TË HERSHËM TË
NDRYSHIMEVE PARAKANCEROZE, TË
KANCERIT TË ZORRRËS SË TRASHË
DHE TË REKTUMIT

Është koha të mendoni për veten.

Kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit – vrasësi i fshehur

Nga kanceri i zorrës së trashë ose i rektumit në Slloveni sëmuren rreth 1600 persona në vit. Për fat të keq, shumë njerëz edhe vdesin nga ky lloj kanceri, sepse sëmundja zbulohet tepër vonë. Ky kancer zhvillohet në trup për disa vite, pa shenja të dukshme të sëmundjes dhe kur shfaqen shqetësimet tipike, sëmundja shpesh ndodhet tashmë në fazën e saj progresive kur mjekimi është i vështirë.

Jo vetëm që kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit është plotësisht i shërueshëm nëse zbulohet shumë herët, por edhe mund të parandalohet nëse zbulohen dhe mënjanoen ndryshimet parakanceroze nga mukoza e zorrëve - polipet.

Përvoja shumëvjeçare e mjekëve jashtë shtetit dhe në Slloveni tregon që rëndimi nga kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit mund të zvogëlohet mjaft me **testime të rregullta të gjakut okult në feçe.** Ky testim mundëson zbulimin dhe mënjanimin e polipeve dhe të sëmundjes në fazën fillestare, kur është tërësisht e shërueshme.

Për këtë arsye, që nga viti 2009, në Slloveni kemi Programin Svit, i hartuar për meshkujt dhe femrat nga 50 deri 74 vjeç.

Pjesëmarrja në Programin Svit mbulohet nga sigurimi juaj shëndetësor bazë dhe shpenzimet e realizimit të këtij programi i mbulon Enti i sigurimit shëndetësor i Sllovenisë.

Programi realizohet me përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Sllovenisë, kurse bartësi i tij është Instituti Kombëtar i Shëndetin Publik.

Me testim të rregullt mund të shpëtoni shëndetin dhe jetën tuaj!

ASNJËHERË MOS E REFUZONI FTESËN – TESTOHUNI!

KANCERI I ZORRËS SË TRASHË DHE I REKTUMIT ËSHTË SËMUNDJE SHUMË E SHPESHTË DHE TINËZARE E CILA MUND TË ZHVILLOHET ME VITE NË TRUP.

Vitet e shkuara, në Programin Svit kemi zbuluar polipe ose fazën e hershme të kancerit tek shumë persona që as e kanë imagjinuar që mund të jenë të sëmurë. Këta persona janë dëshmitarët më të mirë të rëndësisë së Programit Svit, i cili dikujt i ka shpëtuar jetën.

Kur më ka arritur ftesa për Programin Svit, një farë kohe e kam vonuar vendimin për bashkëpunim. Pas kryerjes së testimit më ka arritur rezultati pozitiv. Në feçe është gjetur gjak! Sot jam i shëndoshë. Kam dy fëmijë dhe, po të mos i isha përgjigjur ftesës së Programit Svit, jeta e tyre sot do të ishte plotësisht ndryshe. Edhe pse testi është pak i pakëndshëm, është me rëndësi esenciale ta bëni atë, sepse në të kundërtën mund të jetë tepër vonë.



Marjan Gospič




Gjithsesi ia vlen mundimi që të jeni shëndoshë. Unë, për fat të mirë, jam shëndoshë - në Programin Svit testohem rregullisht, sepse dëshiroj të ruaj shëndetin. Kur e dimë cila është mënyra për të shmangur rrezikun, e vetmja gjë e mençur është ta bëni atë që të shmangni rrezikun tinëzar!

Viki Grošelj, alpinist

Si zhvillohet sëmundja

Kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit çënon edhe meshkujt edhe femrat. Ky lloj kanceri zhvillohet më shpesh nga ndryshimet parakanceroze në mukozë – polipet. Qelizat e polipeve nuk janë të rrezikshme, por me kalimin e viteve mund të ndryshojnë dhe prej tyre mund të zhvillohet kanceri. Sëmundja zhvillohet ngadalë, por në mënyrë shumë të fshehtë. **Nëse kanceri është akoma i kufizuar në polipe, ai mund të mënjanohet lehtë dhe mjekimi onkologjik shpesh nuk nevojitet.** Nëse sëmundja zhvillohet dhe fillon të përhapet nëpër trup përmes enëve të gjakut dhe gjëndrave limfatike, mjekimi mund të jetë shumë i vështirë dhe, fatkeqësisht, jo gjithmonë i suksesshëm. Për këtë arsye, ndryshimet në zorrën e trashë duhen zbuluar sa më shpejt!



Fazat e zhvillimit të kancerit të zorrës së trashë

Rreziku nga zhvillimi i këtij lloji kanceri është më i madh tek: inflamacionet kronike të zorrëve, nga prirja familjare ndaj zhvillimit të polipeve, konsumi i duhanit, konsumi i alkoolit, lëvizja e pamjaftueshme, ushqimi jo i balancuar, mbipesha dhe nga konsumi i tepruar i mishit të kuq.

Kush është më i cënuari

Rreziku nga sëmundja e kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit rritet me kalimin e viteve. Më shumë të sëmurë ka tek personat mbi 50 vjeç, por për fat të keq, kjo sëmundje mund të godasë edhe më të rinjtë.

Veçanërisht të cënuar janë:

- kushërinjtë me afri gjakut të atyre që janë sëmurë me kancerin e zorrës së trashë ose të rektumit para moshës 60-vjeçare (nëse është sëmurë babai, nëna, vëllai ose motra),
- të sëmurët me inflamacione kronike të zorrëve dhe
- të sëmurët me polipe tashmë të zbuluara në zorrë.

MEQË NDRYSHIMET PATOLOGJIKE NË TRUP NUK GJAKOSEN PËRHERË, ËSHTË SHUMË E RËNDËSISHME QË NË PROGRAMIN SVIT TË MERRNI PJESË ÇDO DY VJET. KËSHTU RRRITET MUNDËSIA QË GJAKOSJA EVENTUALE TË ZBULOHEK NË KOHË.



Kur nëna ime është informuar që ka kancer në zorrën e trashë, menjëherë ka filluar mjekimin i cili ka vazhduar 2 vjet. Ka përdorur edhe mjekim alternativ. Por ka qenë shumë vonë. Nënëen e kam humbur kur isha 20 vjeç. Besoj që stili më i përshtatshëm i jetesës dhe kontrolli më i hershëm mund t'ia kishin shpëtuar jetën.



Katja Lihtenvalner

Si të përfshiheni në Programin Svit

1. Sa më parë, plotësoni dhe nënshkruani Deklaratën për pjesëmarrjen me dëshirë dhe dërgojeni atë në Qendrën Svit.
2. Nëse plotësoni kriteret për pjesëmarrje në programin e depistimit, do t'ju arrijnë me postë dy komplete për marrjen e mostrave të feçes. Në privatësinë e shtëpisë suaj, sipas udhëzimeve, do të merrni dy mostra dhe do t'i dorëzoni ato në postë në zarfin bashkangjitur.
3. Në laboratorin qendror të Programit Svit do të analizojmë mostrat dhe do të vërtetojmë nëse në to ka gjak.
4. Rezultatet e analizave do t'ju dërgohen me postë përafërsisht për shtatë ditë.

Nëse në mostrat e feçes nuk do të gjejmë gjak, rezultati do të jetë **negativ**.

Kjo do të thotë që ka shumë mundësi që në zorrë nuk ndodh asgjë e pazakontë – për testim të ri do t'ju ftojme pas dy vitesh dhe, pas kësaj, përsëri pas dy vitesh në vazhdim derisa të mbushni 74 vjet.

Për fat të keq, asnjë testim nuk është plotësisht i besueshëm dhe për këtë arsye duhet të vëzhgoni me kujdes funksionimin e trupit tuaj, veçanërisht jashtëqitjen.

Programi Svit më ka shpëtuar jetën, sepse punonjësit e programit kanë qenë këmbëngulës; dhe për këtë do t'u jem gjithmonë mirënjohëse. Pas kolonoskopisë, koha për mua ka ndaluar, diagnoza e kancerit ka ardhur me hapa të padëgjueshëm. Pas kësaj, gjithçka ka ndodhur shumë shpejt: spitali, operimi, rezultatet. Mezi kuptoja çfarë po ndodhte. Kam pasur fat që nuk më ka ndodhur skenari më i zi. Mos e refuzoni ftesën për analizën e feçes, shpëtoni jetën tuaj!



Marija Hrvatin

Cilat shenja mund të tregojnë që në zorrë ka ndryshime patologjike

- gjaku i dukshëm në feçe,
- ndryshimi i mënyrës së jashtëqitjes (feçe shumë e hollë, kapsllëk pas së cilit vjen diarreja, feçe e zezë),
- dhimbje stomaku të forta dhe që përsëriten,
- humbja e padëshirueshme e peshës së trupit.

NËSE SHFAQEN KËTO PROBLEME, MENJËHERË DUHET TË KONSULTONI MJEKUN TUAJ TË ZGJEDHUR PERSONAL.


Ç' bëhet nëse në mostrat e fecesit gjindet gjak

Nëse rezultati i kontrollit të Programit Svit është **pozitiv**, kjo do të thotë që në mostrat e feces kemi gjetur gjak. Kjo nuk do të thotë doemos që keni kancer – vetëm tregon që në zorrë ka gjakosje. Për këtë arsye, duhet vërtetuar menjëherë pse ka gjak në feçe.

Kontrolli i detajuar i zorrës së trashë, i cili shpjegon shkaqet e gjakosjes, quhet kolonoskopi.

Kryesisht shkak i gjakosjes janë polipet, rritje në mukozë, në të cilat me kalimin e viteve mund të zhvillohet kanceri. Mund të përcaktohen si bomba të pashpërthyer dhe për këtë duhen mënjanuar.

1 ezofagu; 2 stomaku; 3 duodeni;
4 zorra e hollë; 5 apendiksi; 6 apendiksi;
7 zorra e trashë; 8 rektumi; 9 anusi



Kolonoskopia

Përvoja e realizimit të deritanishëm të Programit Svit ka treguar se tek përafërsisht 6% e njerëzve që përfshihen në Programin Svit, në mostrat e feçes zbulohet gjak. Të gjithë atyre që kanë rezultat pozitivë në testin për gjak okult në feçe, u sugjerojmë që në Programin Svit të bëjnë kolonoskopinë. Gjatë këtij testimi, mjeku specialist me një zorrë elastike të trashë sa një gisht, në të cilën ndodhet kamera, do të kontrollojë zorrën e trashë, e cila para kontrollit duhet të pastrohet mirë. Nëse mjeku zbulon polipe, gjatë kontrollit kryesisht mund t'i mënjanojë ato, gjë që është plotësisht e pa-dhimbshme. Mostrat e indeve të tyre dërgohen më tej në kontroll të detajuar mikroskopik.

Nëse do të nevojitet kolonoskopia, fillimisht duhet të vizitoni mjekun tuaj personal të zgjedhur. Së bashku do të planifikoni si të bëni kontrollet që për pjesëmarrësit e Programit Svit i organizon njësia qendrore e programit. Do të kontaktoni qendrën e kontaktit të Programit Svit dhe do të përcaktoni me telefon datën e kontrollit në njërën prej qendrave të autorizuara kolonoskopike Svit, që ndodhen në të gjithë Slloveninë. Bëhet fjalë për qendra diagnostikuese që plotësojnë kriteret më të larta të cilësisë për realizimin e këtyre kontrolleve.

Kontrulli është pak i pakëndshëm, por për shumicën e njerëzve i pa-dhimbshëm.



Çfarë nëse konfirmohet kanceri

Nëse gjatë kontrollit të detajuar konfirmohet që në zorrë ndodhin ndryshime kanceroze, menjëherë duhet filluar me mjekimin. Ai duhet drejtuar nga specialistë të lartë të mjekimit në bashkëpunim me mjekun e zgjedhur personal.

Proceset në mjekësinë moderne dhe metodat e mjekimit mundësojnë që kanceri i zorrës së trashë ose i rektumit të jetë plotësisht i shërueshëm, vetëm nëse zbulohet mjaft herët. Sa më herët – aq më mirë!

PARA SE TË FILLONIM TË REALIZONIM PROGRAMIN SVIT, NË SLLOVENI KISHIM VETËM 12% TË RASTEVE TË KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË TË ZBULUAR NË FAZËN E HERSHME – ME PROGRAMIN SVIT MË SHUMË SE 70% E RASTEVE TË KANCERIT ZBULOHEN AQ HERËT SA QË MJEKIMI ONKOLOGJIK NUK NEVOJITET ASPAK.

MOS KINI FRIKË NGA BOTA NË TRUPIN TUAJ! TESTOHUNI!

Testimi i rregullt i gjakut okult në feçe është investim shumë i rëndësishëm për shëndetin. Për këtë duhet të merrni pjesë në Programin Svit çdo herë që ju ftojnë.

Kolonoskopia ka treguar që kam disa polipe të mëdha. Pa programin e depistimit nuk do të dyshoja për asgjë dhe ka mundësi që gjithçka të përfundonte keq. Falë këtij programi, mund ta shikoj botën e qeshur. Shpresoj që përvoja ime do të nxisë të gjithë ata që kanë mëdyshje të marrin pjesë në Programin Svit dhe të bëjnë kolonoskopinë. Bëjeni këtë dhe shpëtoni shëndetin!



Amalija Falež

Çfarë mund të bëjmë që mos të sëmuremi aspak

- Të marrim pjesë rregullisht në Programin Svit dhe në programet e tjera të depistimit.
- Të vendosim që të jetojmë në mënyrë të shëndetshme. Të lëvizim sa më shumë, të ruajmë peshën normale të trupit, të ushqehemi shëndetshëm.
- të mos konsumojmë duhan, të shmangim konsumin e dëmshëm të alkoolit dhe veset e tjera.
- Të ndjekim trupin tonë gjatë shqetësimeve në zorrë dhe të vizitohemi tek mjeku ynë.
- Të nxisim edhe të tjerët të veprojnë kështu.



Falë Programit Svit kam marrë vesh për diagnozën e kancerit dhe e kam mundur atë me sukses. Të gjithë atyre që do të marrin ftesën, u rekomandoj – pranojeni atë! Vetëm pak dëshirë e mirë nevojitet që të ruani shëndetin tuaj. Na ofrohet një program i shkëlqyer preventiv.

Marija Lili Gričar

Që nga fillimi i Programit Svit në Slloveni, shumë njerëz e kanë zbuluar kancerin në fazën e hershme. Te këta pacientë, operimet janë më pak problematike dhe prognoza është shumë më e mirë. Për këtë arsye, mos e refuzoni ftesën për programin preventiv që mund t'ju shpëtojë jetën!

Prim. dr. Franc Jelenc,
Shef i njësisë klinike për kirurgji
abdominale të UKC Lubjanë



Për programin shtetëror të zbulimit të hershëm të ndryshimeve parakanceroze, kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit

Programi Svit është program shtetëror depistimi, meqë, me zbulimin e hershëm të ndryshimeve parakanceroze, zvogëlohet mundësia e sëmundjes me kancer të zorrës së trashë dhe të rektumit dhe rritet mundësia e shpëtimit të jetës tek të sëmurët tek të cilët është zbuluar kanceri.

Programi është mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Sllovenisë dhe Enti i Sigurimit Shëndetësor i Sllovenisë. Pjesëmarrja në Programin Svit mbulohet nga sigurimi shëndetësor. Ftesa u dërgohet meshkujve dhe femrave 50 deri 74 vjeç. Testimi në Programin Svit duhet bërë çdo dy vjet deri në moshën 74 vjeçare.

Programi Svit është shërbim shëndetësor me cilësi sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe ka parasysh njohuritë dhe përvojat moderne të degës dhe kontrollet më të suksesshme preventive të zbulimit të hershëm të ndryshimeve parakanceroze dhe të kancerit në vendet e BE-së dhe të Botës.

Programi Svit siguron cilësinë e të gjitha shërbimeve, nga depistimi dhe procedura diagnostike deri te mjekimi.

Ne i përsërisim çdo dy vjet ftesat për programin dhe testimet laboratorike të mostrave për gjak okult në feçe. Analizat e mostrave i kryejmë në laboratorin qendror të Programit Svit për të gjithë Slloveninë. Për rezultate pozitive njoftojmë menjëherë pjesëmarrësit dhe mjekët e tyre të zgjedhur personalë, kurse për rezultate negative vetëm pjesëmarrësit. Mjekët personalë të zgjedhur i njoftojmë një herë në vit për të gjithë pacientët e tyre që kanë marrë pjesë në program.

Kolonoskopinë e kryejnë specialistë internistë të kualifikuar – gastroenterologë dhe kirurgë në qendra të organizuara posaçërisht në të gjithë Slloveninë. Analizat e mostrave të indeve bëhen nga specialistë histopatologë. Mjekimi kryhet nga specialistë në qendra shëndetësore me radiografi.

Cilësia eksperte e Programit Svit kontrollohet nga Këshilli i programit, i përbërë nga specialistë të degëve të ndryshme. Bartësi i Programit Svit është Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i cili realizon, udhëheq dhe koordinon programin dhe në realizimin e programit merr pjesë stafi mjekues i institucioneve shëndetësore të të gjithë Sllovenisë.

Informacione shitesë për Programin Svit:

- na kontaktoni çdo ditë nga ora 9.00 deri në 14.00 në numrin e telefonit të qendrës së kontaktit të Programit Svit 01 620 45 21;
- na shkruani në adresën Program Svit, p. p. 241, 1001 Ljubljana ose në info@program-svit.si, dhe me faks në: 01 620 45 29;
- vizitoni internet faqen e Programit Svit www.program-svit.si;
- vizitoni pikën e kontaktit të Programit Svit në qendrën parandaluese të Shtëpisë së shëndetësisë suaj, ose
- vizitohuni tek mjeku juaj i zgjedhur personal.

Sipas dëshirës suaj, materialin për Programin Svit mund ta dërgojmë edhe në gjuhën italiane dhe hungareze. Materiali audio dhe materiali në gjuhën sllovene, në gjuhën e shenjave janë në dispozicion në adresën e internetit www.program-svit.si, ku do të zgjeni edhe informacione të tjera interesante.

Shpresojmë tashmë të keni vendosur për testim në Programin Svit. Duke dëshiruar që të merrni një vendim të mençur lidhur me shëndetin tuaj, ju përshëndesim përzemërsisht.

Pjesëmarrësit e Programit Svit

NIJZ Nacionalni inštitut
za javno zdravje



Center Svit
P.P. 241, 1001 Ljubljana
telefoni 01 62-04-521
telefaksi 01 62-04-529
info@program-svit.si
www.program-svit.si